

VENDIM
Nr.118, datë 7.3.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE TË BURDULLIASIT, NË BASHKINË E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Burdulliasit, në bashkinë e Beratit.

2. Pasuritë, pronë private, me sipërfaqe 2270 m², që shpronësohen, si dhe pronarët përkatës, janë sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë, pronë private, të të cilëve shpronësohen, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është 5 000 000 (pesë milionë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Beratit.

Ky fond u vihet në dispozicion pronarëve të shpronësuar nga bashkia brenda 3 muajve nga data e përfundimit të afatit të shpronësimit.

4. Afati i përfundimit të shpronësimit është data 15.3.2007.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 87 000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohet nga bashkia e Beratit.

6. Afati i përfundimit të punimeve, për objektin “Zgjerimi i varrezave publike Burdullias” të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Beratit.

7. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Beratit. Regjistrimi i ri i pasurisë 2270 m², truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Beratit, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi.

8. Ngarkohet bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

9. Ngarkohet Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE, QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE TË BURDULLIASIT, NË BASHKINË
BERAT**

Nr.	Pronat që do të shpronësohen	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera në lekë	Emri i pronarit
1	Truall	m ²	2270	2200	5 000 000	Feride Ibrahim Bega
	Shuma				5 000 000	Myrifete Iliaz Peshtani